



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 57

Prishtinë, më 13.2.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Shaip Muja, Murat Hoxha, Haxhi Shala dhe Time Kadrijaj.

Mungoi: Sergjan Popoviç, Emilija Rexhepi, Salih Salihu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Burim Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.2.2017;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për 2017 në fushën e mjedisit, i ftuar ministri;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.2.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 1.2.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017 në fushën e mjedisit, i ftuar ministri

Kryetarja **Duda Balje**, lidhur me planin e punës së Komisionit për këtë vit, në fushën e mjedisit, falënderoi ministrin **Ferat Shala**, në cilësinë e sapo të emëruarit si ministër (deri tani ushtrues detyre) për prezencën dhe e ftoi ta marrë fjalën.

Ministri falënderoi për ftesën dhe sugjeroi që sekretari i MMPH-së, **Arben Çitaku**, fillimisht të referojë për punën e sivjetme në MMPH, në mënyrë që pastaj të diskutohet bashkërisht me Komisionin dhe për pyetjet eventuale që do të pasojnë. Sekretari referoi për projektet, sipas strategjisë legislative, një nga një dhe arsyet pse është renditur puna e tillë në këtë ministri dhe njëkohësisht njoftoi Komisionin se kjo agjendë mund të ndryshojë, me bashkëpunimin e MMPH-së dhe të Komisionit, për çdo tremujor, nëse Komisioni e sheh të arsyeshme një gjë të tillë. Ai potencoi punën e ministrisë në fuzionimin (bashkimin) e dy parqeve kombëtare në një ligj (Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna), për shkak të efikasitetit në praktikë rreth mirëmbajtjes dhe çështjeve tjera relevante, ligjin e rinovuar për ndërtimet ilegale, për mbrojtjen e ajrit nga ndotja etj., dhe afatet kur parashihen të arrijnë në Kuvend. **Adem Salihaj**, theksoi se me vite rresht, ministria nuk realizon planin legjislativ. Ligji për mbrojtje nga zhurma nuk ka pasur nevojë të hyjë në strategi, sepse ai gjendet në procedim në Kuvend. Raporti për mjedisin, të cilin e ka shqyrtuar Komisioni, tregon për ndotje të mjedisit, që është alarmuese, si p.sh. Obiliqi, për të cilin ministria nuk harton një plan të menaxhimit, ndërsa si pasojë kemi ndotje të ajrit në rrethinë dhe në kryeqytet, në disa komuna, siç është Ferizaj, ku ka fabrika që ndotin ajrin, nuk ka pikë për matjen e ajrit, për të cilën MMPH-ja duhet të ketë plan të vendosjes së aparaturave për matjen e ajrit. Ai, në vazhdim, shfaqti dyshimin rreth planit urbanistik të Ferizajt, i cili sipas tij, ka pësuar ndryshime dhe është dëmtuar. Në fund, pyeti: Pse ministria nuk i ka shfrytëzuar kapacitetet, sa i përket Ferizajt?

Murat Hoxha, falënderoi ministrinë për planin ambicioz dhe u fokusua për ligjet që kanë të bëjnë me pronën e qytetarit, siç është ai për shpronësime, i cili cenon të drejtën e pronës, ngase qytetarëve iu shkelet e drejta, deri në atë masë, sa që vetëm kur e shohin ekskavatorin në pronën e tyre, pa paralajmërim, gjykatat gjykojnë çështjet që në fakt nuk është e gjykuar. Domethënë, ky ligj duhet të përmirësohet, por jo me ekipin e vjetër, sikurse Ligji për ndërtimet, pa leje, përndryshe këto dy ligje nuk do të kenë sukses. Te Ligji për Odën e Arkitektëve, të futën edhe gjeodetët, ndërsa tek Ligji për shërbimet e ujit, ka kërkesa për ndryshime, si dhe tek Ligji për kadastër, për të cilin shpreson se do të plotësohen. Në vazhdim, ai parashittoi disa kërkesa, që nuk kanë të bëjnë me planin vjetor, por të cilat, ai vazhdimisht i ka kërkuar, siç janë regjistrimi i drejtave të

paluajtshme, miratimi i kadastrit të të dhënave. Po ashtu, plani hapësinor i Kosovës duhet të saktësohet, komunikimi elektronik të instalohet, për leje të ndërtimeve, impiantet e ujerave të zeza të bazohen në plane koncize, minierat e KEK-ut, në hyrje të Gjilanit, te hyrja qarkore, bëhen shpronësime të pakontrolluara, të cilat duhet t'i mbikëqyrë ministria etj.

Shaip Muja, u involvua në diskutim me pyetjet rreth demarkacionit dhe matjes së territorit të Kosovës, për shpronësime në Hade, për të cilin Komisioni ka iniciuar hartimin e ligjit, të cilin ai e konsideron si të panevojshëm dhe i cili nuk do të gjejë zbatim, sikurse edhe Ligji për Obiliqin.

Haxhi Shala, paraprakisht kërkoi nga ministria një raport për vitin e kaluar, për të analizuar më mirë se çka mund të veprohet gjatë këtij viti, njëherësh pyeti për Projektligjin për banimin social, se me çfarë ka të bëjë.

Time Kadrijaj, kërkoi caktimin e prioritetëve nga ministria, sidomos për çështjen e Ligjit për Haden. Po ashtu, pyeti: Cili është roli i ministrisë në Komisionin për matjen e territorit dhe a bëhet kjo matje nga ura e Ibrit apo nga kufijtë që i ka Kosova?

Duda Balje, pyeti ministrin: A ka biseduar me kryeministrin rreth ndërtimit të hidrocentraleve nga personat e interesuar?

Ministri, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara, theksoi se ky plan legjislativ është kërkesë dhe ndahet në dy pjesë, si dhe potencoi disa ligje, për të cilat veçanërisht është kujdesur ministria që t'i rregullojë, siç janë parqet kombëtare (planet e rregullimit të brendshëm të tyre), ndërtimet, ujërat (krijimi i trupit për trajtimin e ujërave) dhe plane tjera. Ligji për planifikim hapësinor, në koordinim me pushtetin lokal, do të ketë hartimin e hartave zonale, ndërsa për Ferizajn, ministria është në rrugë e sipër që t'i rregullojë çështjet e potencuara nga deputeti Salihaj. Sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, ka filluar me Prizrenin dhe do të vazhdojë me Gjakovën, Pejën, si dhe Prishtinën. Për matjen e territorit është kërkuar një përfaqësues i GIZ-it nga ministria, i cili është dërguar sipas kërkesës së Qeverisë. Banimi social është rregulluar më parë nga tri ministri, ndërsa tani është në kompetencën e ministrisë së mjedisit dhe janë ndërprerë tri lloj politikash për politikën sociale. Lidhur me hidrocentralet, çështja qëndron ashtu si ka qenë deri tani dhe nuk mund të veprohet jashtë ligjit. Lidhur me shpronësimet, sekretari tha se më parë ky ligj është hartuar nga ministria e financave, kurse tani hartohet në këtë ministri, i cili do t'i dërgohet Kuvendit në qershor. Rreth kërkesës së deputetit Hoxha për gjeodet, sekretari tha se ata janë të licencuar, por rreth kërkesës për odën e tyre, ai premtoi se do të angazhohet bashkërisht me Komisionin, kur të dërgohet ligji në Kuvend. Për harta zonale komunale, sekretari potencoi se janë duke punuar për këtë çështje dhe së shpejti do të lëshohen lejet online, ndërsa rreth lejeve të ndërtimit, përmes komunikimit elektronik, është në pakon e reformës dhe quhet softueri SPAK, por fillimisht duhet të hartohen hartat zonale. Deri tani, 7 komuna kanë hartuar këto harta zonale me ndihmën e GIZ-it. Rreth kadastrës së të dhënave, deri tani, janë ndërlidhur 38 zyra për regjistrim. **Murat Hoxha**, lidhur me legalizimet, propozoi një vizitë në Maqedoni, për të pasur një model efikas, sepse në zyrën kadastrale të Maqedonisë janë procedurat më të lehta dhe kërkoj njoftimin për mbrojtjen nga tërmeti, sa janë të avancuara, si dhe matjen e deformimeve që bëhen gjatë ndërtimit dhe kush garanton për to. Ministri potencoi se në ligj do të insistohet që çdo inxhinier me licencë të garantojë një standardë të tillë. **Shaip Muja**, duke falënderuar ministrin, inicioi një studim arkivor për rajonin e Bjelluhës, i cili është dashur të përdoret gjatë demarkacionit dhe i cili është zhdukur, ndërsa ministri dhe

sekretari, theksuan se nuk janë kompetentë për demarkacionin dhe nuk kanë njohuri për këtë, por nuk kundërshtojnë mbajtjen e një takimi lidhur me këtë çështje, nëse ka nevojë.

5. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi Komisionin, se në mbledhjen e radhës, edhe një herë, do të konfirmohet projektligji për zhurmën për leximin e dytë, për shkak të mosfigurimit të amendamenteve të ish- deputetes, Alma Lama, një amendament i së cilës është miratuar nga Komisioni dhe është evidentuar si amendament i Komisionit, ngase ajo nuk është më deputete.

Mbledhja përfundoi në orën 13.00.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje